

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 28.02.2025**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:/**

**Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** mr. Dragivca Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 15:35 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.02.2025.
2. Propozim – vendim për heqjen e lejeve për transmetim TV dhe radio.
3. Propozim për ndalim të procedurave të inicuar për heqjen e lejeve për transmetim TV dhe radio.
4. Informacion mbi pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2025.
5. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Proceverbalin e propozuar të seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.02.2025 , me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z. Petrushevski informoi se propozimet i referohen vetëm një vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv, konkretisht për TV Shutel nga Shkupi.

Z. Trajçevski shpjegoi se transmetuesi në fjalë nuk ka paguar kompensimin vjetor në afatin e përcaktuar prej 30 ditësh, as në fatin shtesë prej 15 ditësh, prandaj dhe propozohet që t'i hiqet leja për transmetim televiziv. Gjithashtu, theksoi se përqindja e pagesës së faturave të dhëna ndaj transmetuesit është e lartë dhe arrin në 96,5%, dhe TV Shutel është transmetuesi i parë të cilit i është hequr leja për shkak të borxhit të papaguar. Ai tregoi gjithashtu se gjatë ditës kanë qenë në komunikim me median, por para gjysëm ore kanë marrë njoftim se pagesa nuk do të kryhet.

Z. Petrushevski u shpreh se në periudhën e ardhshme prej 30 ditësh, përmes gjykatës Administrative, do të tentojë ta kthejë lejen dhe të vazhdojë me punë si media në gjuhën rome. Gjithashtu, theksoi se është me rëndësi të veçantë që shërbimi të informojë me kohë median për afatin ligjor për paraqitjen e padisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, për mospagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025).

Transmetuesit të lartpërmendur fatura nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025), i anulohet dhe i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimi e lartpërmendur ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb-faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Pika 3**

Z. Petrushevski propozoi të bëhet një hyrje e përbashkët për pesë propozimet për ndalim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, pasi bëhet fjalë për media që kanë paguar kompensim vjetor. Pastaj, çdo propozim për ndalim të procedurës për ALFA TV Shkup, T.V. KALTRINA Strugë, RFM Shkup, Televizioni Koçan-LD dhe TV MTM Shkup të vihen në votim individual.

Z. Trajçevski shpjegoi se ALFA TV Shkup, T.V.KALTRINA Strugë, RFM Shkup, Televizioni Koçan - LD dhe TV MTM Shkup e kanë paguar kompensimin në afatin shtesë prej 15 ditësh pas fillimit të procedurës. Prandaj, propozohet ndalim i procedurës.

**3.1** Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALFA TV SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-1 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-658/2 datë 26.02.2025, SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkopje, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0001 datë 10.01.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

**3.2** Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP, PA1 nr.08-55 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-662/2 datë 26.02.2025, SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0017 datë 10.01.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

**3.3** Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RFM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-75 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-664/2 datë 27.02.2025, SHTR FM SHPKNJP Shkup, kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e ka paguar plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0034 datë 10.01.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

**3.4** Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërië Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN – LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-663/2 datë 27.02.2025, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN – LD SHPKNJP Koçan, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0014 datë 10.01.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

**3.5** Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV N MTM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-16 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-660/2 datë 27.02.2025, SHTR TV MTM SHPKNJP Shkup, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0010 datë 10.01.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Informacionin mbi pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2025. Ai shpjegoi se bordi ekzekutiv EPRA për shkak të rritjes së shpenzimeve për punën e Sekretariatit, ka vendosur që këtë vit të rrisë anëtarësimin për 200 euro.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka pranuar Informacionin për pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2025, nr.05-210/2 datë 27.02.2025.

Spektori për financa dhe logjistike të paguajë mjetet në shumë prej 4.100 euro për anëtarësim vjetor të Agjencisë në EPRA për vitin 2025, më së voni deri më 14.03.2025.

## **Pika 5**

### **Të ndryshme**

Z. Trajçevski informoi se gjatë miratimit të ndryshimit të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të seancës së kaluar, është bërë gabim teknik. Prandaj, është e nevojshme të fshihen fjalët „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ në nenin 10 dhe neni 20 të Rregullores.

Këshilli i Agjencisë në lidhje me Njoftimin për nevojën e korrigjimit të gabimit teknik të dukshëm në Rregulloren për pagën bruto dhe kompensime tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.03-771/3 datë 28.02.2025, konkludoi të fshihen fjalët: „Gazeta Zyrtare e RMV-së“, në nenin 10 dhe neni 20 të Rregullores.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë tekst të pastruar të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**